

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 1623 / Prot.
113

Tiranë, më 27.8.2024

V E N D I M

Nr. 22, datë 27.8. 2024

MBI

**“SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SIPËRMARRËSIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE “ALBANIAN SATELLITE
COMMUNICATIONS” SH.P.K, KUNDËR VENDIMIT PËRFUNDIMTAR TË
INSPEKTIMIT”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP),
me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi	Frashëri	Kryetar
Z.	Lorenc	Bako	Anëtar
Z.	Bleron	Dokle	Anëtar
Z.	Armer	Juka	Anëtar

dhe sekretare Znj. Evblina Taçi, në mbledhjen e datës 27.08.2024, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues, e ndryshuar si dhe Ligjin Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozim të komisionit *ad hoc* shqyrtoi çështjen me objekt:

- *Shqyrtimi i ankimit administrativ të sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “Albanian Satellite Communications” sh.p.k, kundër vendimit përfundimtar të inspektimit për dënimin administrativ “Paralajmërim”.*

BAZA LIGJORE:

Adresa: Rr. “Reshit Çollaku”, Tiranë Tel: +355 4 2259 571 Fax: +355 4 2259 106 www.akep.al; info@akep.al

1. Neni 128 e vijues i Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
2. Neni 132 e vijues i Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918/2008**);
3. Ligji nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 10433/2011**);
4. Rregullore Nr. 46, datë 27.10.2016, “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike”, miratuar me Vendimin Nr. 2695, datë 27.10.2016, të Këshillit Drejtues; (**Rregullore nr. 46/2016**).

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Ankimi administrativ i sipërmarrësit Albanian Satellite Communications sh.p.k, i datës 12.08.2024, protokolluar në AKEP me shkresë nr.1626/10, datë 12.08.2024);
2. Opioni i komisionit *ad hoc*, ngritur me urdhrin nr.118, datë 19.08.2024, “Për ngritjen e komisionit *ad hoc* për shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit “Albanian Satellite Communications sh.p.k”;
3. Projekt–Vendimin e formatuar dhe arsyetuar;
4. Relacionin shoqërues të Projekt-Vendimit, i hartuar nga Komisioni *ad hoc* i ngritur për shqyrtimin e ankimit administrativ (Relacioni);
5. Praktikën e plotë të inspektimit, e cila përmban materialet si vijon: Autorizimin e Inspektimit Nr. 1623 Prot, datë 18.06.2024; Procesverbalin e Inspektimit nr. 35, datë 21.06.2024, Vendim i ndërmjetëm datë 21.06.2024 “Masë Urgjente për zhbllokimin e menjëhershëm të faqes web “Prapaskena.com” si dhe të çdo faqe tjetër të bllokuar”, Vendimi Përfundimtar i Inspektimit nr. 14, datë 19.07.2024.
6. Shkresë e AKEP nr.1623/12 prot., datë 22.08.2024 “Thirrje në seancë dëgjimore”, për subjektin Albanian Satellite Communications sh.p.k.

Si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

I. Vlerësimi Paraprak:

1. Pas shqyrtimit të ankimit administrativ të sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “Albanian Satellite Communications” sh.p.k, kundër vendimit përfundimtar të inspektimit dhe masës Paralajmërim, të vendosur nga inspektorët e AKEP (GI), Këshilli Drejtues i AKEP konstatoi se sipërmarrësi në fjalë legjitimohet për të

paraqitur ankim administrativ pasi paraqet *prima facie* interes në këtë procedurë, bazuar në nenin 136, të **ligjit nr.9918/2008**.

2. Sipërmarrësi ankimues ka paraqitur ankimin administrativ brenda afatit të parashikuar në nenin 136, të **ligjit nr. 9918/2008**, në nenin 51, të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe pikës 3.9 të Rregullores Nr. 46 datë 27.10.2016, “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike” si dhe ankimi administrativ plotëson efektivisht të gjitha kushtet formale për pranimin e **shqyrtimit të ankimit**, të parashikuara në nenin 135 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

II. Rrethanat e Çështjes:

1. Me Autorizimin e Inspektimit Nr. 1623 Prot, datë 18.06.2024, Kryetari i Këshillit Drejtues të AKEP, ka urdhëruar kryerjen e inspektimit të sipërmarrësit “Albanian Satellite Communications” sh.p.k, për periudhën 19.06.2024 deri më 21.06.2024. Inspektimi i subjektit “Albanian Satellite Communications” sh.p.k, me nr. NIPT: K62115018I u krye me tematikë si më poshtë:

Verifikimi i informacionit në lidhje me ankesën e bërë publike në një prej portaleve mediatike shqiptare (Prapaskena.com), e cila konkludon në respektimin e kufizimeve në lidhje me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme, sipas rregullimeve përkatëse ligjore në fuqi, në mënyrë të veçantë të:

- i) Kushteve të përcaktuara në nenin 15 të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe aktet normative të dala në zbatim të tij, në mënyrë të veçantë të Rregullores Nr. 47, datë 26.10.2017 “Për Zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”.
2. Sipërmarrësi “Albanian Satellite Communications” sh.p.k, nuk është njoftuar në rrugë elektronike mbi Autorizimin e Inspektimit, pasi jemi në kushtet e Inspektimit Rastësor.
 3. Grupi i Inspektimit, pasi ka administruar dokumentacionin e kërkuar, sipas tematikës së përcaktuar në Autorizimin e Inspektimit, si dhe pasi ka inspektuar subjektin në vendin e ushtrimit të veprimtarisë, rezultoi se:

Nga sinjalizimet e marra në terren si dhe nga informacioni i publikuar në median online “Prapaskena.com”, pretendohet se është bllokuar aksesin nga Sipërmarrësi i Komunikimeve Elektronike “Albanian Satellite Communications” sh.p.k për përdoruesit e tij fundorë.


- <https://prapaskena.com/2024/06/16/mafiozi-tan-dulaku-bllokon-mediat-kritike-me-tring-internet-pergjime-e-nderhyrje-ne-telefona-e-te-dhenat-kompjuterike-a-do-veproje-tomi-i-akep-it/>

4. Nisur nga ky fakt i njohur publikisht, strukturat e AKEP realizuan një Inspektim Rastësor pranë Sipërmarrësit të Komunikimeve Elektronike “Albanian Satellite Communications” sh.p.k.

Fillimisht u kontrollua një përdorues fundor dhe më pas në distributorët e sipërmarrësit, aksesit internetit që ASC sh.p.k (Tring) kishte nga faqja web “Prapaskena.com”.

Tek Sipërmarrësi i Komunikimeve Elektronike “Albanian Satellite Communications” sh.p.k u evidentua fakti se plotësonte detyrimin ligjor mbi bllokimin e çdo faqe interneti me përmbytje të paligjshme apo të dëmshme sipas udhëzimeve të institucioneve ligj zbatuese dhe vendimmarrëse, të përcjella nga institucioni i AKEP. Konkretisht Grupi i Inspektimit i AKEP evidentoi në dyqanin e këtij sipërmarrësi faqet *www.bet365.com*, *homelandjustice.vs* dhe *albkanale.com* më poshtë, të cilat rezultuan të bllokuara sipas njoftimeve të institucionit të AKEP, por në përfundim të matjeve të kryera, rezultoi se ky sipërmarrës kishte të bllokuar aksesin e internetit për faqen web *Prapaskena.com*.

5. Grupi Inspektimit të AKEP, gjatë inspektimit rastësor, ka të drejtë që, me vendim të ndërmjetëm, të marrë masa urgjente, kur:
 - *ka një dyshim të arsyeshëm që për shkelje të kërkesave ligjore mund të shkaktohet një dëm i menjëhershëm, i rëndë dhe i pariparueshëm i interesit publik, është e nevojshme kryerja e verifikimeve të mëtejshme dokumentare ose kryerja e ekzaminimeve apo testeve.*
6. Për sa më lart, bazuar në nenin 43 të ligjit 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Rregulloren Nr.46, datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, me qëllim garantimin e shërbimeve të duhura dhe të përshtatshme për çdo përdorues/pajtimtar në territorin e Republikës të Shqipërisë si dhe shmangia e çdo problematike të mundshme e cila mund të sjell kufizime në shërbimet e internetit, Grupi Inspektimit të AKEP mori masën urgjente kundrejt Sipërmarrësit të Komunikimeve Elektronike “Albanian Satellite Communications” sh.p.k që të realizojë menjëherë zhblokimin e faqes web “Prapaskena.com” si dhe të çdo faqe tjetër të bllokuar, që nuk rezulton të jenë përcjellë nga institucioni AKEP.
7. Për realizimin e kësaj mase urgjente brenda afatit të përcaktuar Sipërmarrësi i Komunikimeve Elektronike “Albanian Satellite Communications” sh.p.k rekomandohet:
 - Të realizojë menjëherë dhe të njoftojë në institucionin e AKEP mbi zhblokimin e faqes web “Prapaskena.com” si dhe të çdo faqe tjetër të bllokuar, të cilat nuk rezultojnë të jenë përcjellë nga institucioni i AKEP.



8. Në komunikimin elektronik (e-mail dt. 21.06.2024) Grupi Inspektimit njofton përfaqësuesin e sipërmarrësit "Albanian Satellite Communications" sh.p.k mbi vendimin e ndërmjetëm dt. 21.06.2024 si dhe procesverbalin e inspektimit nr. 35, date 21.06.2024.
9. Në datë 26.06.2024, me shkresën Nr. 1623/1 Prot. i AKEP, sipërmarrësi bazuar në legjislacionin në fuqi ka paraqitur ankim administrativ pranë Këshillit Drejtues të AKEP.
10. Këshilli Drejtues i AKEP me vendim nr. 19 datë 16.07.2024 vendosi të rrëzojë ankimin administrativ të sipërmarrësit "Albanian Satellite Communications" sh.p.k dhe lënien në fuqi të vendimit të ndërmjetëm të Grupit të Inspektimit, datë 21.06.2024.
11. Në vijim të procedurës inspektuese, Grupi inspektimit të AKEP, brenda afateve procedurale mori Vendimin Përfundimtar të Inspektimit nr. 14., datë 19.07.2024 si dhe njoftoi subjektin për këtë Vendim Përfundimtar me shkresën nr. 1623/9 prot, datë 19.07.2024.
12. Referuar konstatimeve të gjetura nga grupi i inspektimit, me Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr. 14, datë 19.07.2024, sipërmarrësi "Albanian Satellit Communications" Sh.p.k, i jepet dënimi "**Paralajmërim**".

Gjithashtu sipas vendimit përfundimtar, ky sipërmarrës duhet të plotësojë:

- Detyrimin ligjor (neni 15 i Ligjit nr. 9918, i ndryshuar "*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*") mbi respektimin e kufizimeve në lidhje me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme, sipas rregullimeve përkatëse ligjore në fuqi, pra bllokimin e çdo faqe interneti me përmbajtje të paligjshme, apo të dëmshme vetëm sipas udhëzimeve të institucioneve ligj zbatuese dhe vendimmarrëse, të përcjella vetëm nga institucioni i AKEP;
- Të marrë masat e nevojshme në rrafsh teknik, për të ofruar shërbim të pandërprerë dhe të pacenuar tek pajtimtarët.

13. Më datë 12.08.2024, nëpërmjet shkresës Nr. 1623/10 Prot. të AKEP, sipërmarrësi "Albanian Satellite Communications" sh.p.k ka paraqitur ankim administrativ pranë Këshillit Drejtues të AKEP ndaj Vendimit përfundimtar të Inspektimit me nr. 14, datë 19.07.2024 dhe dënimit "Paralajmërim".

Konkretisht, në ankimin e tij sipërmarrësi "Albanian Satellite Communications" sh.p.k parashtron se:

- Shoqëria ka vepruar në përputhje me ligjin dhe ka zbatuar në kohë çdo udhëzim apo urdhëresë të ardhur nga AKEP.
- Shoqëria nuk ka bërë asnjë rast bllokimin e faqes "Prapaskena" për përdoruesit fundore. Kjo faqe web është e hapur dhe nuk ka qene e bllokuar. Dhe në këto kushte kërkon nga KD e AKEP Anullimin /Shfuqizimin e vendimit përfundimtar të

inspektimit me nr. 14 datë 19.07.2024” për dënimin administrativ “Paralajmërim”.

14. Bazuar në parashikimet e nenit 135, pika 4 e ligjit nr. 9918 , i ndryshuar “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ankimuesi Albanian Satellite Communications sh.p.k me shkresë nr.1623/12 prot., datë 22.08.2024 “Thirrje në seancë dëgjimore”, është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore me datë 27.08.2024, ora 12:00. Pavarësisht se ky i fundit ka marrë dijeni me datë 23.08.2024, nuk është paraqitur në mbledhjen e Këshillit Drejtues, për shqyrtimin e ankimit administrativ.

KËSHILLI DREJTUES I AKEP

Pasi mori në shqyrtim ankimin administrativ të sipërmarrësit Albanian Satellite Communications sh.p.k, paraqitur me shkresë nr.1623/10 prot., datë 12.08.2024 dhe shqyrtoi materialet pjesë përbërëse të dosjet së inspektimit, konstatimet dhe konkluzionet e arritura në përfundim të procesit të inspektimit,

ARSYETON:

1. Në zbatim dhe konform parashikimeve të Rregullores Nr. 46, datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike” Grupi i Inspektimit ka kryer veprimet procedurale duke zhvilluar procedurë inspektuese sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.
2. Sa i takon shkeljeve të konstatuara gjatë verifikimit dhe procedurës inspektuese, vërehet se subjekti “Albanian Satellite Communications” sh.p.k gjatë veprimtarisë së tij sipas Grupit të Inspektimit ka kryer shkelje të përcaktimeve të nenit 15 të Ligjit nr. 9918, i ndryshuar “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” si dhe të Rregullores Nr. 47, datë 26.10.2017 “Për Zbatimin e Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”.
3. AKEP pasi administron kërkesat nga organet ligjzbatuese me objekt bllokimi i faqeve web me përmbajtje të paligjshme, në zbatim të shkronjës e) të nenit 15 të Ligjit nr. 9918, i ndryshuar “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe bazuar në shkronjën e) të pikës 1 të Nenit 9 të Aneksit E) të Rregullores Nr. 47, datë 26.10.2017 “Për Zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”, njofton me shkresë zyrtare por edhe përmes postës elektronike sipërmarrësit e komunikimeve elektronike për të kryer veprimet e mbylljes së aksesit të faqeve elektronike.

Sipërmarrësi i Komunikimeve Elektronike “Albanian Satellite Communications” sh.p.k duhet të plotësojë detyrimin mbi bllokimin e çdo faqe interneti me përmbajtje të paligjshme apo të dëmshme vetëm sipas udhëzimeve të institucioneve ligjzbatuese dhe vendimmarrëse, të përcjella nga AKEP.



4. Në përfundim të procedurës për shqyrtimin e ankimit dhe të pretendimeve të sipërmarrësit “Albanian Satellite Communications” sh.p.k, pas arsytimit dhe akteve të paraqitura nga Grupi i Inspektimit, si dhe nga analiza e plotë e çështjes objekt shqyrtimi, konstatohet se, vendimi përfundimtar është marrë nga G.I në mbështetje dhe në përputhje me procedurën inspektuese.
5. Sipas kuadrit ligjor në fuqi, Vendimi përfundimtar i inspektimit është akti që mbyll një procedurë inspektimi dhe nxirret nga grupi i inspektimit pas nënshkrimit të procesverbalit.

Në rastin konkret kur janë konstatuar shkelje, grupi i inspektimit bazuar në procesverbalin e inspektimit dhe administrimin e shpjegimeve, provave dhe kundërshtimeve të dhëna nga subjekti i inspektimit, ka përpiluar vendimin përfundimtar të inspektimit dhe brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit, e ka dërguar atë pranë subjektit të inspektimit duke përcaktuar edhe masat administrative.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, në pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në zbatimin e nenit 128 e në vijim të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të rrëzojë ankimin administrativ të sipërmarrësit “Albanian Satellite Communications” sh.p.k.
2. Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar të Grupit të Inspektimit, nr. 14, datë 19.07.2024.
3. Të njoftohet sipërmarrësi “Albanian Satellite Communications” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Tomi Frashëri

Lorenc Bako

Bleron Dokle

Armer Juka

